



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e gjuhës B (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri 1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: alma.pinari@unitir.edu.al
almapinari@gmail.com

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit studenti duhet të përcaktojë konceptet bazë të morfologjisë (kuptimi gramatikor, forma gramatikore, kategoria gramatikore). Të njohë dhe diferencojë konceptet bazë të morfologjisë; Të ushtrojë kompetencën ligjërimore gramatikore saktë dhe lirshëm. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyetojë mbi gabimet e bëra duke i vlerësuar dhe korrigjuar nga vetë ai. Të aftësohet në perceptimin e disa ideve fundamentale në fushën e sintaksës si degë tjetër e gramatikës;

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet:

1. Të përforcojë njohuritë e tij gramatikore, dhe nëpërmjet tyre aftësinë ligjërimore në gjuhë të huaj;
2. Të bëjë analizën morfemore dhe fjalëformuese, në bazë të njohurive të marra;
3. Të jetë i aftë të analizojë një tekst të çfarëdoshëm.

Rezultate të pritshme :

1. Zotërimi i koncepteve bazë të morfologjisë dhe sintaksës. Studenti do të jetë në gjendje të përcaktojë dhe të dallojë konceptet themelore të morfologjisë (kuptimi gramatikor, forma dhe kategoria gramatikore) si dhe të kuptojë bazat e sintaksës si degë e gramatikës.
2. Zhvillimi i kompetencës gjuhësore dhe ligjërimore. Studenti do të jetë i aftë të përdorë gjuhën me korrektësi gramatikore në formë të folur dhe të shkruar, duke ndërtuar fjali të sakta dhe të rrjedhshme.
3. Aftësi për analizë morfemore dhe fjalëformuese. Studenti do të jetë në gjendje të analizojë njësitë përbërëse të fjalës (morfemat) dhe të kuptojë proceset e formimit të fjalëve të reja.
4. Aftësi për të analizuar dhe interpretuar tekste. Studenti do të jetë i aftë të analizojë një tekst të çfarëdoshëm nga pikëpamja gramatikore, të vlerësojë saktësinë e strukturës së tij dhe të identifikojë gabimet përkatëse.